

Mersel Bilalli, PhD¹

UDC:
341.24

MARRËVESHTJET NDËRKOMBËTARE
(Efektet juridike, ndikimi, rezervat dhe pushimi i
marrëveshjeve)

МЕЃУНАРОДНИТЕ ДОГОВОРИ
(Правни ефекти, влијание, резерви и престанок)

INTERNATIONAL TREATIES
(Legal Effects, Impacts, Reserves, and Termination of
Treatise)

ABSTRACT

The international community has not yet build a central legislative body that would adopt laws that would bind the entire international community. But it is a reality that the world's globalization process significantly affects the unification of many legal rules, even by relativizing state borders. However, it will take a longer time to talk about an efficient world parliament. For now, the UN as an international universal organization is empowered to adopt resolutions, declarations and conventions at special conferences, which are also accorded to the will of states, i.e. representatives of states in this organization.

In principle, the agreements cause legal effects only between the contracting parties (countries). So agreements do not oblige third countries (*pacta tertiis nec prosunt*). The principle of sovereignty means that treaties can not impose any obligations on states that have not

¹ mersel.b@gmail.com

participated in their affiliation. But exceptionally there are agreements, which also establish rights for some or more countries (third countries). With the Declaration on the Suez Channel (1957), although issued by a small group of states, it was guaranteed the right to sail through the Suez Channel to all countries of the world. Peace agreements have also produced rights and obligations for other states (Danube navigation, freedom of navigation through the Chilean channel, etc.).

Even imperative norms (*jus cogens*), without the dilemma that they are mandatory for all states member and non-member of the agreement. For example, rules for the ban of slavery, for the elimination of discrimination, the prohibition of war, etc. These rules oblige also non-member states.

Through reserves, the state that has put reserve in an international treaty wants to be a contracting party to that treaty, but it may happen that the obstacle is any various definitions of this act. Therefore, if the state has put in reserve (if the agreement so permits), then the state does not oblige those provisions in which it has reserved.

Marrëveshtjet ndërkombëtare (Efektet juridike, ndikimi, rezervat dhe pushimi i marrëveshjeve)

E drejta ndërkombëtare kontraktuese përfshin të gjitha aktet juridike ndërkombëtare, të cilët prodhojnë të drejta dhe obligime për subjektet ndërkombëtare. Në fakt, përmes marrëveshjeve ndërkombëtare, shtetet reciprokisht reduktojnë apo delegojnë pjesë të sovranitetit në sfera të ndryshme (ekonomike, politike, sociale, ushtarake, kulturore, sportive, etj.). Gjithashtu, me ndihmën e marrëveshjeve ndërkombëtare, subjektet ndërkombëtare ndikojnë edhe në ndërtimin e sistemit të vet juridik, si edhe të atij ndërkombëtar.

Bashkësia ndërkombëtare akoma nuk disponon me parlament botëror i cili do të miratonte ligje që do të vlenin për mbarë bashkësinë ndërkombëtare. Fakt është se procesi i globalizimit të botës nënkupton edhe unifikimin e shumë rregullave juridike dhe relativizmin apo heqje të kufijve shtetërorë. Por, do të duhet edhe një kohë më e gjatë, që të mund të flasim për nevojën e një parlamenti efikas botëror. Tani për tani OKB si organizatë universale ndërkombëtare është e autorizuar që të miratojë rezoluta, deklarata dhe konventa në konferenca të veçanta, të cilat po ashtu miratohen me vullnet të shteteve.

Në mungesë të një organi qendror botëror, shtetet si subjekte ndërkombëtare përmes marrëveshjes në mes veti, rregullojnë marrëdhëniet e tyre në sfera të ndryshme (ekonomike, tregtare, politike, sociale, kulturore, shkencore, krijimin e normave juridike, etj.). Marrëveshjet (apo traktatet) ndërkombëtare janë akte juridike ndërkombëtare që lidhen në pajtim me vullnetin e shteteve, me qëllim të krijimit të të drejtave dhe obligimeve apo raporteve juridike mes tyre.²

Rregullat juridike për rregullimin e të drejtës kontraktuese, janë ndërtuar përmes një praktike të gjatë kohore, pra përmes normave juridike zakonore. Me kalimin e kohës, shtrohet edhe nevoja e kodifikimit të së drejtës kontraktuese. Të drejtën kontraktuese, shtetet amerikane kanë filluar ta kodifikojnë qysh me marrëveshjen e Havanës (1928). Kombet e Bashkuara kanë punuar gati 20 vite në kodifikimin e kësaj lëmie (1949-1969), me ç'rast miratohet Konventa e Vjenës për të Drejtën Kontraktuese (1969). Pas miratimit të kësaj konvente, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së ka rekomanduar mundësinë e nxjerrjes edhe të një konvente për të drejtën kontraktuese mes shteteve dhe organizatave ndërkombëtare, si dhe në mes vet organizatave ndërkombëtare (e cila miratohet në vitin 1986 në Vjenë).

Konventa e Vjenës për të drejtën kontraktuese (1969)

Edhe pse Konventa e Vjenës për të drejtën kontraktuese u miratua në vitin 1969, ajo hyri në fuqi në vitin 1980 (pasi këtë vit u pat deponuar instrumenti i 35 i ratifikimit). Me hyrjen në fuqi të kësaj konvente, praktikisht u kodifikua një lëmi tejet e rëndësishme e së drejtës ndërkombëtare, e cila gjer atëherë kishte qenë e mbuluar me norma juridike zakonore. Konventa në fjalë përfshin pjesë të rëndësishme të elementeve të kontraktimit në mes shteteve: a) vullnetin për lidhjen e marrëveshjeve; b) formën e lidhjes së traktateve; c) ratifikimin e marrëveshjeve; d) autorizimin për lidhjen e tyre; e) interpretimin e marrëveshjeve; f) abrogimin dhe ndërprerjen e marrëveshjeve; g) hyrjen në fuqi të marrëveshjeve; h) rezervat në marrëveshjet, etj. Çështjet që nuk janë rregulluar nga normat e konventës në fjalë, mbeten që edhe më tej të rregullohen me norma zakonore ndërkombëtare.³

² Sipas Alfaros, shpirti i marrëveshjes është vullneti i palëve kurse trupi i saj është instrumenti i shkruar.

³ Shih, Sinclair, *The Vienna Convention on the Law of Treaties*, 2nd ed., 1984.

Konventa e Vjenës për të drejtën kontraktuese të organizatave ndërkombëtare (1986)

Rrethveprimi, funksionimi dhe puna e organizatave ndërkombëtare, respektivisht të drejtat dhe obligimet, si dhe autorizimet e organizatave burojnë nga vullneti i shteteve. Megjithatë, nuk është e mundshme dhe funksionale që për shumëçka të konsultohen shtetet anëtare të organizatës ndërkombëtare. Prandaj organizatat ndërkombëtare, gjithnjë e më shumë funksionojnë si autonome në kuadër të ingerencave të veta. Me zmadhimin e numrit dhe relevancës së organizatave ndërkombëtare në botë, imponohet edhe nevoja për nxjerrjen e një konvente të veçantë që do t'i rregullonte çështjet që kanë të bëjnë me lidhjen e marrëveshjeve në mes shteteve dhe organizatave ndërkombëtare, si dhe në mes vet organizatave ndërkombëtare.⁴ Prandaj në vitin 1986 miratohet Konventa e Vjenës, e cila si burim të dytë të së drejtës kontraktore për shumë çështje është e ngjashme me Konventën e Vjenës së vitit 1969.

Pra, Konventa e Vjenës e vitit 1986, mbulon vetëm sferën e lidhjes së marrëveshjeve në mes shteteve dhe organizatave ndërkombëtare dhe në mes vet organizatave ndërkombëtare. Pra kjo konventë nuk ka të bëjë me çështjen e lidhjes së marrëveshjeve në mes shteteve. Këtë materie kemi thënë se e mbulon Konventa e Vjenës për të drejtën kontraktuese të vitit 1969. Gjithashtu dispozitat e konventës së vitit 1986, nuk kanë veprim retroaktiv (pra ato vlejnë për marrëveshjet që janë lidhur pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente, e jo edhe për rastet e lidhjes së marrëveshjeve para miratimit të saj).

Organet kompetente për lidhjen e traktateve

Konsiderohet se nuk ekziston marrëveshja ndërkombëtare, nëse ajo nuk është e lidhur nga ana e përfaqësuesve të autorizuar të shtetit. Parimisht, të drejtën për lidhjen e traktateve ndërkombëtare e kanë organet të cilat përfaqësojnë shtetin jashtë ose organ tjetër i autorizuar nga këta organe. Konventa e Vjenës, në nenin 7, përcakton se kompetentë për të lidhur, nënshkruar dhe për të zhvilluar bisedime për lidhjen e marrëveshjeve pa autorizim të veçantë janë - shefat e shteteve, kryetarët e qeverive, ministrat e punëve të jashtme, shefat e misioneve

⁴ Për tekstin e Konventës, shih, JRMP, br.1/1986, f. 123 – 150.

diplomatike (vetëm në sferën e marrëdhënieve bilaterale), dhe përfaqësuesit e shteteve në konferencat ndërkombëtare apo në organizatat ndërkombëtare. Persona tjerë mund të lidhin traktate vetëm nëse janë të autorizuar nga organet kompetente.

Konventa nuk i përfshin komandantët ushtarakë, të cilët sipas të drejtës së luftës kanë të drejtë të lidhin marrëveshje për armëpushim, kapitullim, këmbimin e robërve, etj. Kjo e drejtë është e rregulluar me norma të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

Përmbushja e marrëveshjeve ndërkombëtare

Sot, marrëveshjet ndërkombëtare, përveç që i tangojnë shtetit palë të marrëveshjes, ato shpesh u dedikohen edhe individëve në kuadër të shtetit (për shembull, aktet ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut). Përmbushja e obligimeve nga marrëveshja, është më praktike në shtetet unitare se sa te ato federative, ku shpesh ekziston ndeshje e kompetencave.⁵ Disa marrëveshje vlejné në mbarë territorin e shtetit, kurse tjerat në një pjesë të tij. Është parim i përgjithshëm i së drejtës dhe etikës ndërkombëtare, që marrëveshjet të përmbushen me vullnet të mirë (*pacta sunt servanta*). Siç është ligji për të drejtën e brendshme, ashtu edhe marrëveshjet ndërkombëtare janë për shtetet në bashkësinë ndërkombëtare. Pas lidhjes së një marrëveshjeje, shtetet nuk mund të lidhin marrëveshje tjera, të cilat do të dëmtonin obligimet e marra nga marrëveshja paraprake.⁶ Mos përmbushja e obligimeve nga traktatet ndërkombëtare, paraqet shkelje të së drejtës ndërkombëtare. Pra *pacta sunt servanta*, sipas funksionit të vet paraqet normë imperative (*jus cogens*) në përmbushjen e obligimeve nga marrëveshjet.

⁵ Ekziston edhe e ashtuquajtura *klauzolë federale*, sipas së cilës pushteti federal nuk garanton realizimin e marrëveshjes në ndonjë njësi të veten federale. Për shembull, Konventa mbi refugjatët e vitit 1951, (neni 41/b).

⁶ Në kohërat më të hershme shtetet kanë përdorur mjete të ndryshme për t'u siguruar se marrëveshja e caktuar do të realizohet, si p.sh. betimi në Zot, dhënia e pengjeve, hipoteka, garantimi nga një shtet tjetër, okupimi i dhunshëm, etj. Britania e Madhe i ka dhënë Francës peng dy lordë në vitin 1748, si garancë për plotësimin e Marrëveshjes për paqe të Ahenit. Apo rasti i dhënies së pengut, kur Polonia detyrohet t'i jep Prusisë stolitë e kurorës.

Gjithashtu edhe Traktati i Paqes së Versajit (1919), ka paraparë, në nenin 428, garanca se Gjermania do ta përmbushë marrëveshjen – okupimin e një pjese të një pjese territorit në perëndim të Rajnës.

Veprimi i marrëveshjeve

Parimisht marrëveshjet shkaktojnë efekte juridike vetëm mes palëve⁷ (shteteve) kontraktuese. Marrëveshjet që kanë hyrë në fuqi, për shtetin palë të asaj marrëveshjeje ato kanë fuqinë e ligjit. Ato mbeten në fuqi pa marrë parasysh ndryshimet politike që mund të ndodhin në ndonjë vend që është anëtare e marrëveshjeve.⁸

Parimisht, marrëveshjet nuk i obligojnë shtetet e treta (*pacta tertiis nec prosunt*). Parimi i sovranitetit nënkupton se traktatet nuk mund t'u imponojnë kurrfarë detyrimesh shteteve të cilat nuk janë anëtare në lidhjen e tyre. Konventa e Vjenës (1969) përcakton se nuk mund të krijohen obligime për palën e tretë, përveç nëse shteti i tretë vet i pranon ato obligime shprehimisht. Kurse kjo në fakt paraqet marrëveshje të re në mes palëve kontraktuese dhe shtetit të tretë.⁹ Ekzistojnë marrëveshje, të cilat përcaktojnë të drejta edhe për ndonjë apo më shumë shtete tjera. Prej tyre, varet se a do dëshirojnë t'i shfrytëzojnë ato të drejta apo jo. Me Deklaratën mbi kanalin e Suezit (1957), e cila sjellet nga një grup i vogël shtetesh, garantohet e drejta e lundrimit për të gjitha shtetet e botës. Edhe marrëveshjet paqësore kanë prodhuar të drejta dhe obligime për shtetet tjera (lundrimi nëpër Danub, liria e lundrimit nëpër kanalin e Kilit, etj).

Përrjashtimisht, kur është fjala për marrëveshjet ndërkombëtare të cilat përmbajnë norma imperative (*jus cogens*), atëherë pa dilemë se ato janë obligative për të gjitha shtetet, qofshin anëtare apo joanëtare të marrëveshjes (për shembull, normat për ndalimin e tregtisë me robër, për eliminimin e diskriminimit, ndalimin e luftës, etj). Karta e Kombeve të Bashkuara, parasheh obligime edhe për shtetet joanëtare, sidomos në sferën e ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Rezervat te marrëveshjet ndërkombëtare

Rezerva paraqet deklaratë të njëanshme të një pale kontraktuese, me rastin e nënshkrimit, ratifikimit, akceptimit, aprovimit apo aderimit

⁷ Përveç marrëveshjeve që krijojnë norma juridike, edhe atë vetëm ato të cilat obligojnë të gjitha shtetet. P.sh. Karta e OKB-së obligon edhe shtetet jo anëtare të Kombeve të Bashkuara.

⁸ Më gjërësisht shif , Klabbers and Lefeber, eds., *Essays on the Law of Treaties* (1998).

⁹ Vukas B, *relativno djelovanje medjunarodnog ugovora*, Zagreb, 1975.

të traktatit, me të cilën një shtet dëshiron të përjashtojë apo modifikojë efektet juridike të një apo më shumë dispozitave nga traktati.

Pra, në këtë rast, shteti që ka vënë rezervë në ndonjë marrëveshje ndërkombëtare, dëshiron të jetë palë e traktatit, por pengesë i është ndonjë përcaktim nga ky akt. Nëse shteti ka vënë rezervë (nëse atë e lejon marrëveshja), atëherë shtetin nuk e obligojnë ato dispozita në të cilat ka vënë rezervë. Shpeshherë vet traktatet parashohin vënien e ndonjë rezerve, apo përcaktojnë se në cilat nene apo pjesë të marrëveshjes mund apo nuk mund të vihet rezervë. Marrëveshja mundet edhe shprehimisht të ndalojë vënien e rezervave. Neni 19, i Konventës së Vjenës (1969), përcakton se në këtë konventë mund të vihen rezerva, përveç nëse: 1) vet traktati këtë e ndalon; 2) nëse traktati lejon vënien e rezervave, por rezerva të cilën dëshiron shteti ta vë, nuk bënë pjesë në rezervat e lejuara.¹⁰ Shteti që ka vënë rezervë, ka të drejtë të njëjtën në çdo moment atë ta tërheq, duke e pranuar marrëveshjen në tërësi.

Kohëve të fundit ekzistojnë marrëveshje multilaterale të cilat u mundësojnë shteteve seleksionimin e dispozitave të cilat dëshirojnë t'i akceptojnë, por njëherit në mënyrë decide potencojnë minimumin e dispozitave që shtetet duhet t'i pranojnë.¹¹

Pushimi i veprimit të traktateve

Supozim bazik te shumë marrëveshje është se ato lidhen për kohë të pacaktuar. Madje edhe kur ekzistojnë afate të parapara në vet traktatet për revizion apo për vazhdim, një gjë e tillë bëhet më tepër për shkaqe pragmatike apo për dëshirën që marrëveshja e caktuar të pësojë ndryshime, që të jetë sa më efikase dhe praktike. Disa marrëveshje, për nga natyra e vet janë të tilla sa që nuk mund të zgjasin shumë pasi me kryerjen e obligimeve të caktuara nga palët, mbeten pa lëndë (për shembull, marrëveshja në mes shteteve për demarkacionin e kufirit). Përgjithësisht, traktatet ndërkombëtare pushojnë së vepruari në disa mënyra:

1) Me kalimin e afatit të paraparë në traktat. Shumë marrëveshje lidhen për afat të caktuar dhe me kalimin e këtij afati ato pushojnë së vepruari. Përjashtim bëjnë marrëveshjet që krijojnë norma juridike, të cilat lidhen për afat të pacaktuar (aktet mbi të drejtat njerëzore). Po

¹⁰ Gjerësisht, J.K.Gamble, *reservation to Multilateral Treaties: A Macroscopic View of State Practice*, American Journal of International Law, vol. 74, 1980.

¹¹ Këso forme janë disa marrëveshje në kuadër të Këshillit të Evropës, si psh. Karta për gjuhët rajonale dhe të pakicave dhe Karta për pushtetin lokal.

ashtu, ekzistojnë marrëveshje të cilat parashohin kohëzgjatje të caktuar, por që nëse nuk paralajmërohen tërheqje nga ndonjë anëtare, ato vazhdojnë me automatizëm.¹²

2) Me realizimin e qëllimit të traktatit. Realizimi i qëllimit të traktatit nënkupton edhe pushimin e vet këtij akti, për shembull, marrëveshje për ndërtimin e autostradës së përbashkët në vijën kufitare, ndërtimi i urës mbi lumin kufitar, apo vënia e gurëve kufitarë, etj.

3) Me marrëveshjen e vet palëve kontraktuese. Sipas normave të së drejtës ndërkombëtare, palët anëtare të një marrëveshjeje, gjithnjë mund të vendosin që traktati ekzistues të pushojë më tej së vepruari.

4) Me lidhjen e marrëveshjes së re e cila zhvlerëson marrëveshjen paraprake. Po ashtu, palët mund të vendosin që të lidhin marrëveshje të re për shkak të ndryshimit të rrethanave të ndryshme, me ç'rast marrëveshja paraprake pushon së ekzistuari. Kështu, miratimi i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare i vitit 1946, ka bërë të palëndë Statutin e Gjykatës së përhershme të Drejtësisë të vitit 1921.

5) Pamundësia e plotësimit të marrëveshjes. Pamundësia e realizimit të marrëveshjes nga ndonjëra apo nga të gjitha palët kontraktuese, nënkupton situata kur traktati i caktuar objektivisht dhe fizikisht është i përealizueshëm. Kjo mund të ndodhë edhe për shkak forcës madhore (*vis maior*),¹³ zhdukjes apo shkatërrimit të objektit (për shembull, zhdukjet ujdhesa për të cilën palët janë marrë vesh për preskripcion).

6) Tërheqja e njëres palë kontraktuese në bazë të dispozitave të marrëveshjes. Traktati mund të pushojë edhe me tërheqjen e njëres palë kontraktuese, nëse këtë e parasheh marrëveshja. Shumë marrëveshje përcaktojnë edhe afatin paralajmëruar (gjashtëmuor, një vit apo dy vite), nëse ndonjëra nga palët dëshiron të tërhiqet nga marrëveshja. Disa traktate aspak nuk mundësojnë tërheqjen e njëanshme, për shembull, traktatet mbi përcaktimin e kufirit.

7) Humbja e subjektivitetit ndërkombëtar të njëres palë kontraktuese. Nëse njëra palë kontraktuese humb subjektivitetin ndërkombëtar (pra, shteti apo organizata ndërkombëtare anëtare e traktatit nuk ekziston më), atëherë traktati pushon së vepruari (përveç disa marrëveshjeve

¹² Konventa mbi pengimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit, e cila është lidhur për 10 vjet, me atë që me automatizëm vazhdohet në çdo pesë vite, përveç nëse ndonjë shtet tërhiqet nga marrëveshja.

¹³ Si fuqi madhore (*vis maior*) që mund të ndikojnë në marrëveshjet ndërkombëtare mund të jenë - tërmetet e fuqishme, vullkanet, vërshimet, etj.

që janë të lidhura për territor të caktuar). Pra, disa marrëveshje, për shkak të natyrës së tyre, siç kemi thënë, kalojnë te suksesori.

8) Ndryshimi i dukshëm i rrethanave (rebus sic stantibus). Konventa e Vjenës (1969), është shumë rigorozë në lidhje me ndryshimin e dukshëm të rrethanave. Domosdo duhet të jenë në pyetje ndryshime të rrethanave qenësore, të cilat nuk kanë mundur të parashikohen gjatë lidhjes së marrëveshjes dhe të kenë ndodhur pa vullnetin e palëve. Në këtë rast, ndryshimi i dukshëm i rrethanave paraqet bazë që njëra palë të tërhiqet nga marrëveshja e caktuar, pasi realizimi i mëtejme i marrëveshjes do t'i bënte shumë dëm njërës palë (p.sh. zvogëlimi apo zmadhimi drastik i çmimit të ndonjë lënde që është objekt shitblerjeje në mes palëve).

Përmbyllje

Sa më shumë që bota dhe bashkësia ndërkombëtare integrohet dhe globalizohet, aq më tepër edhe marrëveshjet ndërkombëtare fitojnë në relativitet. Shumë marrëveshje gjithnjë e më shumë obligojnë edhe shtete të treta të cilat nuk janë anëtare të tyre, e as që kanë marrë pjesë në bisedime.

Kjo shtron nevojën e një kodifikimi të ri të së drejtës kontraktuese, e cila do të duhet të filloj të çlirohet nga parimi i ngurtë se marrëveshjet ndërkombëtare në parim nuk prodhojnë të drejta dhe detyrime për palët e treta. Jeta shoqërore ekonomike në botë dukshëm ndryshon, madje me dinamikë të madhe. Andaj edhe normat juridike ndërkombëtare duhet ta përcjellin këtë dinamikë.

Conclusion

The more the world and the international community moves towards integration and globalization, the more the international treaties become relativity. Many agreements increasingly involve third countries, which are not their members, nor have they participated in the negotiations.

This raises the need for a new codification of the contractual law, which will have to be released from the firm principle that international agreements in principle do not produce rights and obligations to third parties. Socio-economic life in the world clearly changes, even with great dynamics. Therefore, international legal norms should follow this dynamic.

LITERATURA

Bilalli M. E Drejta Ndërkombëtare Publike, Shkup, FON University 2008.

Dixon and McCorquodale, Cases and Materials on International Law, (4th ed., 2003), Ch. 3.

Dixon, Textbook on International Law (4th ed., 2000), Ch. 3.

Gamble J.K, *reservation to Multilateral Treaties: A Macroscopic View of State Practice*, American Journal of International Law, vol. 74, 1980.

Klabbers and Lefeber, eds., Essays on the Law of Treaties (1998).

Sinclair I.M. The Vienna Convention on the Law of Treaties, 2nd ed., 1984.

Harris, Cases and Materials on International Law (5th ed., 1998), Ch. 10

Vukas B, relativno djelovanje medjunarodnog ugovora, Zagreb, 1975.

Dokumente ndërkombëtare

1969 Vienna Convention on the Law of Treaties (VCLT)

(tekstin e Konventës, shih, JRMP, br.1/1986, f. 123 – 150).

Karta Evropiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave, 1992 (miratuar nga Këshilli i Evropës).

Karta për pushtetin lokal, 1985 (miratuar nga Këshilli Evropës)